



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 774 Prot.

Pogradec, më 18.02. 2025

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**ZNJ.MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

I nderuar Zoti Kryetar ,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues , :

**MBI DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.3 DATË 27.01.2025
“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-
NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2025”.**

Me respect,
KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr.i faqeve A4 të project-vendimit : 1
Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë ____ . ____ 2025

MBI DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.3 DATË 27.01.2025“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2025”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, 1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”;nenit 21 të ligjit nr.57/2019,”Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”,vendimit nr.597,datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave”Për përcaktimin e procedurave,të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”,ndryshuar me Vendimin nr.855, datë 26.12.2024 :

**KËSHILLI I BASHKIAK
VENDOSI:**

Në vendimin nr.3 datë 27.01.2025, të Këshillit Bashkiak , bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1.Pika 3 , “Të moshuarit të mbetur vetëm që janë në varfëri ekstreme dhe refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme”, bëhet;
- **Të moshuarit të mbetur vetëm të cilët kanë aplikuar në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike dhe janë refuzuar për pikë të pamjaftueshme , jetojnë në varfëri ekstreme sipas verifikimit të kryer nga administratori shoqëror i ndihmës ekonomike,pa pension ose me pension shumë të ulët nën pensionin minimal.**

**KRYETAR
Manjola KAMOLLI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

RELACION

**MBI DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.3 DATË 27.01.2025
“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-
NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2025”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, 1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 21 të ligjit nr.57/2019,”Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave”Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, ndryshuar me Vendimin nr.855, datë 26.12.2024 , Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Pogradec ka paraqitur **një ndryshim për pikën nr.3 të VKB nr.3 datë 27.01.2025** në kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2025.

Sipas shkresës nr.115/1Prot.datë 06.02.2025 nga Prefekti i Qarkut Korçë , kriteri nr.3 i VKB nr.3 datë 27.01.2025 për trajtimin nëpërmjet fondit të kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2025, kërkon rregulla e kriteret të veçanta shtesë nga Nj.V.V-të , të cilat duhet të përcaktojnë qartë mënyrën dhe instrumentat e verifikimit të të moshuarve lidhur me masën e përfitimeve që rrjedhin nga pensioni i pleqërisë që do të konsiderohet ekstreme nga bashkia, pika 3, “Te moshuarit të mbetur vetëm që janë në varfëri ekstreme dhe refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme”, i bëhet një rivlerësim duke bërë disa shtesa ku kemi përcaktuar më konkretisht cilat kategori e përfitojnë.

Në këtë kategori do të futen , të moshuarit të ngelur vetëm , që kanë aplikuar në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike dhe janë refuzuar për pikë të pamjaftueshme dhe sipas verifikimit të kryer nga administratori shoqëror i ndihmës ekonomike është në varfëri ekstreme ,pa pension ose një pension nën pensionin minimal.

Administratorët shoqërorë të ndihmës ekonomike kryejnë verifikimin në familje bëjnë vlerësimin social ekonomik , nëse plotësojnë kriteret për të përfitur nga Fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike, bëjnë rekomandimin në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike. Dokumentacioni mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, është si më poshtë;

a. Vlerësimi Social Ekonomik.

b. Fletë përmbledhje e daljes nga sistemi i pikëzimit.



c.Fotokopje e kartës së identitetit.

d.kontrata e energjisë për të përfituar kompesim energjie.

e.Vërtetim i masës së pensionit.

Konceptoi: Luljeta Mançellari

Miratoi: Ivana Capollari

Jurist : Klevisa Liçkollari

Konfirmoi: Dritan Babasuli

KRYETAR

Illir Xhakolli